



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-016/01-95254/25, më 02 JUL 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** vazhdimi i inkasimit të faturave të lëshuara për tremujorin e parë dhe të dytë, deri në momentin që përfundon procesi i negocimit ndërmjet KRM “Pastrimi” Sh.A dhe Kryeqytetit, për periudhën në fjalë.
2. Të hyrat e mbledhura nga inkasimi për tremujorin e parë dhe të dytë, në mënyrë periodike do të transferohen tek KRM Pastrimi.
3. Transferimi i këtyre mjeteve do të bëhet, duke bartur edhe “Listën e Klientëve”, të cilët kanë realizuar pagesa, për faturat e lëshuara për periudhën në fjalë.
4. Mjetet e inkasuara nga Komuna e Prishtinës, tek KRM Pastrimi do të transferohen në baza mujore. Koha e transferimit do të jetë nga data 1 deri me datën 10 të muajit pasues.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

